



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

DREJTIMI MËSIMOR “MEKANIKË”

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Mekanikë**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Mekanikë”, Niveli I dhe “Mekanik i kombinuar (pilot-PEM)”, Niveli I; në profilin “Makina metalpunuese”, Niveli II, “Konstruksione metalike”, Niveli II dhe profilin “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Mekanikë”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”.
- .

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Mekanikë**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë.

Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “**Mekanikë**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Bazat e teknologjisë mekanike, kl. 10;
2. Teknologji mekanike, kl.11;
3. Rezistencë materialesh, kl.12;
4. Bazat e sipërmarrjes, kl.13;
5. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl.13;
6. Detale makinash, kl.13;
7. Projektim i procesit teknologjik mekanik, kl.13;

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e teknologjisë mekanike	2	1
2	Teknologji mekanike	6	4
3	Rezistencë materialesh	34	22
4	Bazat e sipërmarrjes	19	12
5	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	8
6	Detale makinash	64	40
7	Projektim i procesit teknologjik mekanik	20	13
	TOTALI	159	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Bazat e teknologjisë mekanike”, kl.10 (2 orë)**
- Materialet metalike 2 orë
- b) **“Teknologji mekanike”, kl.11 (6 orë)**
- Elementet e regjimeve të prerjes. Procesi i krijimit të ashklës 3 orë
 - Tornoja universale vidëprerëse 3 orë
- c) **“Rezistencë materialesh”, kl.12 (34 orë)**
- Hyrje në rezistencën e materialeve 1 orë
 - Trau në rezistencën e materialeve, tensionet, provat e materialeve, tensioni i lejuar, koeficienti sigurisë 3 orë
 - Tërheqja, kushti i qendrueshmërisë në tërheqje 1 orë
 - Marrëdhëniet ndërmjet zgjatimit, ngarkesës, seksionit dhe modulit të elasticitetit 2 orë
 - Shtypja, kushti qendrueshmërisë në shtypje. Ushtrime për shtypjen 2 orë
 - Prerja, kushti qendrueshmërisë në prerje. Ushtrime për prerjen 4 orë
 - Përdredhja, tensioni tangencial në përdredhje, shprehja e parë e tensionit tangencial 3 orë
 - Përkulja, hipotezat mbi të cilat mbështetet studimi i përkuljes. Mpk dhe forcës prerës 4 orë
 - Rezistenca e përbërë. Përkulja dhe përdredhja. Ushtrime për përkuljen dhe përdredhjen 4 orë
 - Përkulja dhe tërheqja (ose shtypja). Ushtrime për përkuljen dhe tërheqjen (ose shtypjen) 4 orë
 - Përdredhja dhe tërheqja (ose shtypja). Ushtrime për përdredhjen dhe tërheqjen (ose shtypjen) 4 orë
 - Epja, ngarkesa kritike dhe tensionet kritike 2 orë
- d) **“Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 dhe 13: (19 orë)**
- Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
 - Legjislacioni i punës 5 orë
 - Menaxhimi i informacionit 4 orë
 - Menaxhimi i marketingut 5 orë
- e) **“Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13: (14 orë)**
- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor 3 orë
 - Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis 3 orë
 - Zhvillimet demografike dhe mjedisi 4 orë
 - Shoqëria e konsumit dhe mbetjet 4 orë

f) “ Detale makinash ”, kl.13:	(64 orë)
<ul style="list-style-type: none"> • Njohuri të përgjithshme për llojet e bashkimeve, klasifikimi i tyre, veçoritë, përdorimi • Bashkimet me ribatina, llogaritja e bashkimeve me ribatina • Bashkimet me saldim, llogaritja e bashkimeve me saldim • Bashkimet me kiaveta, llogaritja e bashkimeve me kiaveta • Bashkimet me shliza, llogaritja e bashkimeve me shliza • Bashkimet me fileta, llogaritja e bashkimeve me fileta • Transmisionet me rripa, njohuri të përgjithshme, llojet, përdorimi • Llogaritja e transmisioneve me rripa të sheshtë • Llogaritja e transmisioneve me rripa trapezoidalë • Transmisionet me rrota të dhëmbëzuara, njohuri të përgjithshme, llojet, përdorimi. Raporti i transmisionit dhe rendimenti • Elementët gjeometrik të rrotës cilindrike me dhëmbë të drejtë dhe me dhëmbë të pjerrët • Transmisionet me rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë dhe të pjerrët, elementet gjeometrike të transmisionit • Llojet dhe shkaqet e shkatërrimit të rrotave me dhëmbë • Transmisionet me rrota konike me dhëmbë të drejtë, elementet gjeometrike të transmisionit • Llogaritja e transmisioneve me rrota konike me dhëmbë të drejtë • Akset dhe boshtet, njohuri të përgjithshme, veçoritë, përdorimet, llogaritja e tyre • Mbështetëset e akseve dhe të boshteve (kushinetat), njohuri të përgjithshme, veçoritë, rregullat e montimit • Llogaritja e kushinetave rrëshqitëse dhe rrokullisëse • Sustat, njohuri të përgjithshme, veçoritë, llojet, karakteristikat, përdorimi • Bashkueset, njohuri të përgjithshme për bashkueset, llojet e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> 2 orë 4 orë 4 orë 4 orë 3 orë 7 orë 3 orë 4 orë 4 orë 2 orë 2 orë 4 orë 1 orë 2 orë 4 orë 5 orë 3 orë 3 orë 2 orë 1 orë
g) “ Projektim i procesit teknologjik mekanik ”, kl.13:	(20 orë)
<ul style="list-style-type: none"> • Analiza teknologjike e konstruksionit të detalit • Zgjedhja e llojit të gjysem-fabrikatit dhe mënyra e përgatitjes së tij • Përcaktimi i shtesave të punimit mekanik dhe bërja e skicës së gjysëm-fabrikatit • Përcaktimi i rradhës së kryerjes së operacioneve dhe elementeve të tij • Zgjedhja e instrumenteve punuese dhe matëse • Përcaktimi i regjimeve të punës • Zgjedhja e makinave, pajisjeve dhe veglave të punës 	<ul style="list-style-type: none"> 2 orë 2 orë 3 orë 5 orë 2 orë 4 orë 2 orë